

VENDIM
Nr. 663, datë 15.11.2017

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË PASURISË
NR. 8/123, ZONA KADASTRALE 8330,
ME EMËRTIMIN “INKUBATORI
I BIZNESIT”, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “ç”, dhe 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të pasurisë nr. 8/123, zona kadastrale 8330, me emërtimin “Inkubatori i biznesit”, Tiranë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim realizimin e funksioneve ekonomike.

2. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Bashkia Tiranë dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Bashkia / Komuna : Tiranë		Identifikoi: Ing. R. Halidini, Ing. G. Naci, Ing. V. Vaj, Top. H. Madoni								
Fusha e përdorimit të Pronës: Administrative		Supervizoi: Përgj. sek. inventarizimit L. Drobomiraj								
		Drejtori: Vitor Hashademi								
		Aprovoi: Kryetar Edi Rama								
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeks i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emri i Pronës Adresa	Sip. Totale e Pronës (m ²)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertesa (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret Prona	Institucioni / Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni / Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Shënime të veçanta (Shënime të vlerës)
2901	8330 L.M-10	8/123		Inkubatori i Biznesit Rr. J. Misja				Bashkia	Ink. Biznesit	
2902	8360 K-12,13	3/76		Ujesjallës Kanalizime, Tirane Rr. Dibres Cytet				M.P.P.T	Ujesj. Kanalizime	
2903	8360 K-12,13	3/76		Ujesjallës Kanalizime, Tirane Rr. Dibres Fahat				M.P.P.T	Ujesj. Kanalizime	
2904	8260 R-9	4/52		Instituti Nderimit Tirane Rr. S. Delvina				M.P.P.T	I.P.U.N.	
2905	8350 N-11	6/219		Albtransporti Bul. Zog I				M.P.P.T	Albtransporti	